



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE

Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla dhe te Mesme

URDHER

Nr. 321 Date 1.10.2003

PER

TRANSFORMIMIN E NDERMARRJES SHTETERORE "UJESJELLES KANALIZIME QYTET" GJIROKASTER NE SHOQERI ANONIME "UJESJELLES KANALIZIME QYTET" SH.A. GJIROKASTER

Drejtuar: Ndermarrjes "Ujesjelles Kanalizime Qytet" Gjirokaster

Duke marre parasysh percaktimin e kapitalit themeltar te shoqerise qe do te krijohet nga transformimi i Ndermarrjes "Ujesjelles Kanalizime Qytet" Gjirokaster nga eksperte kontabel te autorizuar miratuar me shkresen nr.2161/3, date 12.05.2003 "Per verifikimin dhe vertetimin e bilancit te reformimit",

KONSTATOVA

Se ne baze te nenit 1 te Ligjit nr.8885, date 22.04.2002 "Per disa ndryshime ne ligjin nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Ligjin nr.8067, date 15.02.1992; nr.8099, date 28.03.1996; nr. 8158, date 1.09.1997; nr.8482, date 10.05.1999, dhe me Dekretet nr.1195, date 14.08.1995 dhe nr.1615, date 20.09.1996 duhet te krijohen aktet e themelimit te Shoqerise,

Persa me siper, ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise,

URDHEROJ:

1. Transformimin e Ndermarrjes "Ujesjelles Kanalizime Qytet" Gjirokaster ne Shoqeri te formes anonime "Ujesjelles Kanalizime Qytet" sh.a. Gjirokaster.
2. Anetare te keshillit te pare mbikqyres emerohen:
Z. Bujar Reme
Z. Dashamir Sejdo
Z. Thoma Rrushaj
3. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla e te Mesme dhe Drejtoria Juridike te ndjeke zbatimin e ketij urdheri.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

